



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 115, datë 10.12.2009

MBI

KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT PËR VITIN 2010

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nenit 45, paragrafi 4, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në bazë të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 45 “shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e RSH në sigurimin e detyrueshëm motorik, janë të detyruara të kontribuojnë çdo vit financiarisht në fondin e kompensimit, në përpjestim të drejtë, me primet bruto të shkruara në këto lloj sigurimesh, në vitin paraardhës. Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve, sipas pikave 2 e 3 shkronja b, dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Byroja Shqiptare e Sigurimit ka depozituar në Autoritet propozimin për kontributin e shoqërive të sigurimit në fondin e kompensimit për vitin 2010.

Byroja Shqiptare e Sigurimit në propozimin e parë ka kërkuar krijimin e fondit të kompensimit për vitin 2010 në masën 4% të primeve të sigurimit të detyrueshëm të arkëtuara për vitin 2009.

Autoriteti pasi shqyrtoi informacionin e depozituar nga Byroja mbi gjendjen e fondit të kompensimit për periudhën 1 janar -10 dhjetor 2009, si dhe gjendjen e pritshme të fondit të kompensimit deri më 31 dhjetor 2009, konstatoi se viti 2010, rezulton me mungesë në tepricën e fondit të kompensimit më 10.12. 2009, ashtu dhe në pritshmërinë e këtij fondi deri në 31.12.2009.

Pra propozimi i Byrosë nuk plotëson qëllimin e fondit të kompensimit, pagesën e dëmeve pasurore dhe jo pasurore sipas parashikimeve të ligjit të mësipërm.

Nisur nga ky fakt, Byroja në propozimin e dytë, propozon krijimin e fondit të kompensimit për vitin 2010, në masën 10% të primeve bruto të shkruara të sigurimit të detyrueshëm motorik për vitin 2009. Ky fond do të mbulojë mungesat si dhe do të sigurojë vijueshmërinë e pagesave të dëmeve në përputhje me parashikimet ligjore.

Për sa më sipër Autoriteti,

V E N D O S I:

1. Miratimin e propozimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit për krijimin e fondit të kompensimit për periudhën 01 janar 2010 deri në 31 dhjetor 2010, në masën 10% të primeve bruto të shkruara në sigurimin e detyrueshëm motorik të vitit 2009.

2. Ky fond duhet të derdhet me këste të barabarta tremujore, brenda muajit të parë të çdo tremujori.
3. Ngarkohet Byroja dhe Departamentet përkatës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI